



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 119, datë 25.07.2025

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloret e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, listuar si më poshtë:

- **Rregullore nr. 1, datë 25.01.2016** “Për procedurat dhe mënyrën e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit për aksionarët e shoqërisë së sigurimit”;
- **Rregullore nr. 137, datë 21.12.2015**, “Procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/ shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/ mbikëqyrës, administratorit/ anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”;
- **Rregullore nr. 79, datë 31.08.2015** “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”;
- **Rregullore nr. 48, datë 30.06.2015** “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”;
- **Rregullore nr. 85, datë 03.07.2017** “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”;
- **Rregullore nr. 1, datë 31.01.2024** “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”;
- **Rregullore nr. 112, datë 31.08.2020** “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të

investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”;

- **Rregullore nr. 91, datë 31.05.2023** “Për kërkesat e licencimit dhe të funksionimit të shtëpisë së klerimit dhe kundërpalës qendrore (CCP)”;
- **Rregullore nr. 90, datë 31.05.2023** “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së Depozitarit Qendror të Titujve”;
- **Rregullore nr. 89, datë 31.05.2023** “Për kriteret e licencimit dhe funksionimit të Bursave dhe operatorëve të tregut, që vënë në funksion veprimtarinë e një tregu të rregulluar”;
- **Rregullore nr. 195, datë 29.12.2020** “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”;
- **Rregullore nr. 188, datë 16.12.2020** “Për regjistrimin dhe veprimtarinë e agjentit të lidhur të shoqërisë komisionere”.

2. Rregulloret e përcaktuara në pikën 1, ndryshojnë sipas teksteve bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Ngarkohet Departamenti i Zbatueshmërisë dhe Çështjeve Ligjore, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Mimoza KAÇI

- I. Në rregulloren nr. 1, datë 25.01.2016** “Për procedurat dhe mënyrën e depozitimit të informacionit dhe dokumentacionit në lidhje me burimin e kapitalit për aksionarët e shoqërisë së sigurimit”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 3, bëhen ndryshimet me përmbajtje si vijon:

- Pika 1, shkronja b), nënpika iv, riformulohet me përmbajtje si vijon:
“*Strukturën e kapitalit të personit juridik, deri në aksionarin e fundit përfitues;*”
- Në pikën 3, shifra “30%” zëvendësohet me shifrën “25%”.
- Pika 4, riformulohet me përmbajtje si vijon:
“*Çdo vit brenda muajit janar shoqëria e sigurimit depoziton në Autoritet çdo ndryshim të aksionarit të fundit përfitues.*”
- Pas pikës 4, shtohet pika 5, me përmbajtje si vijon:
“*Shoqëritë e sigurimit kanë detyrimin të garantojnë përmbushjen e vazhdueshme të kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga individët që mbajnë pozicionet përkatëse. Vlerësimi i këtyre kriterëve duhet të kryhet rregullisht, të paktën një herë në vit, si dhe në çdo rast kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në rrethanat që mund të ndikojnë në profilin e individit. Shoqëritë e sigurimit depozitojnë në Autoritet çdo vit, brenda muajit mars të vitit pasardhës vetëdeklarimet përkatëse të çdo individi mbi vijueshmërinë e përmbushjes së kriterëve.*”

Neni 2

Në nenin 7, pas pikës 4, shtohet pika 5, me përmbajtje si vijon:

“*Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit të aksionarëve, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.*”

- II. Në rregulloren nr. 137, datë 21.12.2015** “Mbi procedurën, afatet dhe dokumentacionin e nevojshëm/ shtesë për miratimin e emërimit dhe riemërimit të anëtarit të këshillit të administrimit/ mbikëqyrës, administratorit/ anëtarit të bordit të drejtorëve të shoqërisë së sigurimit”, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 3, pas pikës 4, shtohet pika 5, me përmbajtje si vijon:

“Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kritereve të përshtatshmërisë dhe integritetit të personave të përcaktuar në këtë rregullore, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.”

Neni 2

Në nenin 6, pas pikës 2, shtohet pika 3, me përmbajtje si vijon:

“Shoqëritë e sigurimit kanë detyrimin të garantojnë përmbushjen e vazhdueshme të kritereve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga individët që mbajnë pozicionet përkatëse. Vlerësimi i këtyre kritereve duhet të kryhet rregullisht, të paktën një herë në vit, si dhe në çdo rast kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në rrethanat që mund të ndikojnë në profilin e individit. Shoqëritë e sigurimit depozitojnë në Autoritet çdo vit, brenda muajit mars të vitit pasardhës vetëdeklarimet përkatëse të çdo individi mbi vijueshmërinë e përmbushjes së kritereve.”

III. Në rregulloren nr. 79, datë 31.08.2015 “Për miratimin/licencimin e personave për të ushtruar veprimtarinë e agjentit në sigurime, si dhe rastet e mospranimit të regjistrimit të tij dhe refuzimit të licencës”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 12, pika 1, riformulohet me përmbajtje si vijon:

“Kërkesat për miratimin/licencimin e subjekteve të përcaktuara në këtë rregullore duhet të përmbushen gjatë gjithë kohës që miratimi/licencat janë të vlefshme. Monitorimi i përmbushjes së kërkesave bëhet nga Autoriteti offsite një herë në vit dhe nëpërmjet inspektimeve në vend kur e gjykon të arsyeshme.”

Neni 2

Në nenin 13, pas pikës 2, shtohet pika 2/1, me përmbajtje si vijon:

“Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit të personit juridik, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.”

- IV. Në rregulloren nr. 48, datë 30.06.2015** “Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 12, pika 1, riformulohet me përmbajtje si vijon:

“Kërkesat për licencimin e subjekteve të përcaktuara në këtë rregullore duhet të përmbushen gjatë gjithë kohës që licencat janë të vlefshme. Monitorimi i përmbushjes së kërkesave bëhet nga Autoriteti offsite një herë në vit dhe nëpërmjet inspektimeve në vend kur e gjykon të arsyeshme.”

Neni 2

Në nenin 13, pas pikës 2, shtohet pika 2/1, me përmbajtje si vijon:

“Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit të personit juridik, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.”

- V. Në rregulloren nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 4, pas pikës 2, shtohet pika 2/1 dhe në nenin 16, pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me përmbajtje si vijon:

“Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit të personit juridik, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.”

Neni 2

Në Kreun V, shtohet neni 21/1, me përmbajtje si vijon:

“Neni 21/1

Ruajtja e kërkesave të licencimit

Kërkesat për licencimin e subjekteve të përcaktuara në këtë rregullore duhet të përmbushen gjatë gjithë kohës që licencat janë të vlefshme. Monitorimi i përmbushjes së kërkesave bëhet nga Autoriteti offsite një herë në vit dhe nëpërmjet inspektimeve në vend kur e gjykon të arsyeshme.”

VI. Në rregulloren nr. 1, datë 31.01.2024 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërisë administruese të fondeve të pensionit privat dhe depozitarit të fondeve të pensionit privat të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 7, pika 1, nëndarja I, shkronja g), riformulohet me përmbajtje si vijon:

“g) Informacion në lidhje me strukturën e pronësisë dhe aksionarët e subjektit, si më poshtë:

- i) Të dhëna mbi strukturën e kapitalit të personit juridik deri në aksionarin e fundit;*
- ii) Të dhënat e parashikuara në shkronjën i), plotësohen edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik, që zotërojnë mbi 25% të aksioneve me të drejtë vote.”*

Neni 2

Në nenin 9, pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me përmbajtje si vijon:

“Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga personat e përcaktuar në këtë rregullore, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.”

VII. Në rregulloren nr. 112, datë 31.08.2020 “Për licencimin dhe rregullat shtesë të licencimit të shoqërive administruese të fondeve, depozitarëve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, licencimin dhe regjistrimin e sipërmarrjeve të investimeve kolektive të themeluara në Republikën e Shqipërisë”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 7, pika 1, nëndarja I, shkronja g), riformulohet me përmbajtje si vijon:

“g) Informacion në lidhje me strukturën e pronësisë dhe aksionarët e subjektit, si më poshtë:

- i) Të dhëna mbi strukturën e kapitalit të personit juridik deri në aksionarin e fundit;*
- ii) Të dhënat e parashikuara në shkronjën i), plotësohen edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik, që zotërojnë mbi 25% të aksioneve me të drejtë vote.”*

Neni 2

Në nenin 9, pas pikës 1, shtohet pika 1/1, me përmbajtje si vijon:

“Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kritereve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga personat e përcaktuar në këtë rregullore, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.”

VIII. Në rregulloren nr. 91, datë 31.05.2023 “Për kërkesat e licencimit dhe të funksionimit të shtëpisë së klerimit dhe kundërpalës qendrore (CCP)”, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Në nenin 9, pika 1, pas shkronjës b), shtohet shkronja b/1), me përmbajtje si vijon:

“b/1) Informacionin në lidhje me strukturën e pronësisë dhe aksionarët e subjektit, si më poshtë:

- (i) Të dhëna mbi strukturën e kapitalit të personit juridik deri në aksionarin e fundit;*
- (ii) Të dhënat e parashikuara në pikën (i), plotësohen edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik, që zotërojnë mbi 25% të aksioneve me të drejtë vote.”*

Neni 2

Në fund të nenit 13, shtohet paragrafi me përmbajtje si vijon:

“Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga personat e përcaktuar në këtë rregullore, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.”

Neni 3

Në nenin 29, shtohet pika 14, me përmbajtje si vijon:

“Subjektet sipas kësaj rregulloreje, kanë detyrimin të garantojnë përmbushjen e vazhdueshme të kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga individët që mbajnë pozicionet përkatëse. Vlerësimi i këtyre kriterëve duhet të kryhet rregullisht, të paktën një herë në vit, si dhe në çdo rast kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në rrethanat që mund të ndikojnë në profilin e individit. Subjektet depozitojnë në Autoritet çdo vit, brenda muajit mars të vitit pasardhës vetëdeklarimet përkatëse të çdo individit mbi vijueshmërinë e përmbushjes së kriterëve.”

IX. Në rregulloren nr. 90, datë 31.05.2023 “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së Depozitarit Qendror të Titujve”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 6, pas pikës 4, shtohet pika 4/1, me përmbajtje si vijon:

“Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga personat e përcaktuar në këtë rregullore, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.”

Neni 2

Në nenin 15, në pikën 2, shkronjat a) dhe b), riformulohen me përmbajtje si vijon:

*“a) Të dhëna mbi strukturën e kapitalit të personit juridik deri në aksionarin e fundit;
b) Të dhënat e parashikuara në shkronjën a), plotësohen edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik, që zotërojnë mbi 25% të aksioneve me të drejtë vote.”*

Neni 3

Në nenin 39, pas pikës 9, shtohet pika 10, me përmbajtje si vijon:

“Subjektet sipas kësaj rregulloreje kanë detyrimin të garantojnë përmbushjen e vazhdueshme të kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga individët që mbajnë pozicionet përkatëse. Vlerësimi i këtyre kriterëve duhet të kryhet rregullisht, të paktën një herë në vit, si dhe në çdo rast kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në rrethanat që mund të ndikojnë në profilin e individit. Subjektet depozitojnë në Autoritet çdo vit, brenda muajit mars të vitit pasardhës vetëdeklarimet përkatëse të çdo individ mbi vijueshmërinë e përmbushjes së kriterëve.”

- X. Në rregulloren nr. 89, datë 31.05.2023** “Për kriteret e licencimit dhe funksionimit të Bursave dhe operatorëve të tregut, që vënë në funksion veprimtarinë e një tregu të rregulluar”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 7, pika 1, shkronja e), riformulohet me përmbajtje si vijon:

“e) Aplikimi për licencim duhet të përfshijë informacion në lidhje me strukturën e pronësisë

dhe aksionarët e subjektit, si më poshtë:

- i) Të dhëna mbi strukturën e kapitalit të personit juridik deri në aksionarin e fundit;*
- ii) Të dhënat e parashikuara në shkronjën i), plotësohen edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik, që zotërojnë mbi 25% të aksioneve me të drejtë vote.”*

Neni 2

Në nenin 20, pas pikës 4, shtohet pika 5, me përmbajtje si vijon:

“Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga personat e përcaktuar në këtë rregullore, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.”

Neni 3

Në nenin 22, pas pikës 2, shtohet pika 3, me përmbajtje si vijon:

“Subjektet sipas kësaj rregulloreje kanë detyrimin të garantojnë përmbushjen e vazhdueshme të kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga individët që mbajnë pozicionet përkatëse. Vlerësimi i këtyre kriterëve duhet të kryhet rregullisht, të paktën një herë në vit, si dhe në çdo rast kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në rrethanat që mund të ndikojnë në profilin e individit. Subjektet depozitojnë në Autoritet çdo vit, brenda muajit mars të vitit pasardhës vetëdeklarimet përkatëse të çdo individit mbi vijueshmërinë e përmbushjes së kriterëve.”

XI. Në rregulloren nr. 195, datë 29.12.2020 “Për licencimin e shoqërisë komisionere, regjistrimin e degës së shoqërisë së huaj komisionere dhe njohjen e shoqërisë së huaj komisionere”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 7, pas pikës 4, shtohet pika 4/1, me përmbajtje si vijon:

“Informacionin në lidhje me strukturën e pronësisë dhe aksionarët e subjektit, si më poshtë:

- i) Të dhëna mbi strukturën e kapitalit të personit juridik deri në aksionarin e fundit;*
- ii) Të dhënat e parashikuara në shkronjën i), plotësohen edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik, që zotërojnë mbi 25% të aksioneve me të drejtë vote.”*

Neni 2

Në nenin 8, pika 6, shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 22, shtohet pika 4, me përmbajtje si vijon:

“Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga personat e përcaktuar në këtë rregullore, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.”

Neni 4

Në kreun VI, pas nenit 23 shtohet neni 23/1, me përmbajtje si vijon:

“Neni 23/1

Monitorimi i vazhdueshëm

Subjektet sipas kësaj rregulloreje kanë detyrimin të garantojnë përmbushjen e vazhdueshme të kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga individët që mbajnë pozicionet përkatëse. Vlerësimi i këtyre kriterëve duhet të kryhet rregullisht, të paktën një herë në vit, si dhe në çdo rast kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në rrethanat që mund të ndikojnë në profilin e individit. Subjektet depozitojnë në Autoritet çdo vit, brenda muajit mars të vitit pasardhës vetëdeklarimet përkatëse të çdo individ mbi vijueshmërinë e përmbushjes së kriterëve.”

XII. Në rregulloren nr. 188, datë 16.12.2020 “Për regjistrimin dhe veprimtarinë e agjentit të lidhur të shoqërisë komisionere”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 7, bëhen shtesa dhe ndryshime me përmbajtje si vijon:

- Pika 2, shkronja e), riformulohet me përmbajtje si vijon:

“Informacionin në lidhje me strukturën e pronësisë dhe aksionarët e subjektit, si më poshtë:

- i) Të dhëna mbi strukturën e kapitalit të personit juridik deri në aksionarin e fundit;*
- ii) Të dhënat e parashikuara në shkronjën i), plotësohen edhe nga aksionarët e aksionarit person juridik, që zotërojnë mbi 25% të aksioneve me të drejtë vote.”*

- Pas pikës 4, shtohet pika 5, me përmbajtje si vijon:

“Agjenti i lidhur ka detyrimin të garantojnë përmbushjen e vazhdueshme të kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga individët që mbajnë pozicionet përkatëse. Vlerësimi i këtyre kriterëve duhet të kryhet rregullisht, të paktën një herë në vit, si dhe në çdo rast kur ndodhin ndryshime të rëndësishme në rrethanat që mund të ndikojnë në profilin e individit. Agjenti i lidhur depoziton në Autoritet çdo vit, brenda muajit mars të vitit pasardhës vetëdeklarimet përkatëse të çdo individi mbi vijueshmërinë e përmbushjes së kriterëve.”

Neni 2

Në nenin 13, pas pikës 3, shtohet pika 3/1, me përmbajtje si vijon:

“Autoriteti, gjatë vlerësimit të përmbushjes së kriterëve të përshtatshmërisë dhe integritetit nga personat e përcaktuar në këtë rregullore, verifikon listat e shpallura të sanksioneve të OKB-së dhe të BE-së, njoftimet e OKB-së, si dhe listat e Integruara të Personave të shpallur.”